



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTER
KËSHILI I BASHKISË

Nr. 1439 Prot.

Mallakaster, më 02 09.2025.

VENDIM

Nr. 09, datë 26.03.2025

Për miratimin e dokumentit "Strategjia vendore për zvogëlimin e nga fatkeqësitë n dhe Plani i Veprimit" në territorin e Bashkisë Mallakaster.

Në mbështetje të nenit 3, "Misioni i vetëqeverisjes vendore ", të nenit 9, "Të drejtat dhe përgjegjësitë", nenit 29 "Funkcionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", nenit 18 "Seancat e këshillimeve me bashkësinë" dhe nenit 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; nenit 10 "Strategjia Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë" nenit 11 "Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë", nenit 12 "Harmonizimi i planeve të zhvillimit urban me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të nenit 30 "Bashkitë", shkronja "c", të nenit 67, "Inspektimi" shkronja "b" si edhe të nenit 68 "Kundërvajtjet administrative", të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", për hartimin dhe miratimin e dokumentit "Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit", në territorin e saj, Bashkia Mallakaster,

VENDOSI

1. Miratimin e dokumentit " Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit " në territorin e Bashkisë Mallakaster, sipas kërkesave të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".

2. Ky dokument të konsiderohet si një dokument themelor për planifikimin dhe zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe për zhvillimin urban në territorin e Bashkisë Mallakaster. Dokumenti të publikohet dhe të bëhet i aksesueshëm për të gjitha Drejtoritë përkatëse dhe për publikun, si dhe të përdoret si referencë në hartimin e planeve dhe strategjive të tjerë zhvillimore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Territorit.

KRYETAR

Nezhmi Solaj

